



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-87
Prishtinë, më 24 dhjetor 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 24 DHJETOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci dhe Myfera Shinik, anëtarë të Kryesisë, ndërsa munguan: Naim Maloku dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga NDI, Shefki Kastrati,
Nga OSBE, Florjana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe disa pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 dhjetor 2009,

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare:

- 2.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës,
- 2.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve,
- 2.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër korrupsionit,
- 2.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar,
- 2.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
- 2.6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
- 2.7 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,
- 2.8 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për borxhet publike,
- 2.9 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010,
- 2.10 Informatë e Ministrisë për Punë të Brendshme lidhur me rastin Tisa,
- 2.11 Kërkesa e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 dhjetor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 dhjetor 2009, u miratua pa vërejtje.

Ibrahim Makolli pati vërejtje në Transkriptin e mbledhjes lidhur me apostrofimin e emrit të tij për rrjedhjen e një informate në opinion. Ai mohoi të ketë dhënë ndonjë informatë nga mbledhja e Kryesisë së Kuvendit për medie.

Kryetari tha se reagimi i Ibrahim Makollit është i pranueshëm dhe i kërkoi falje për atë që është thënë në mbledhjen e mëparshme.

Xhavit Haliti pati vërejtje në transkript lidhur me vendimin e Kryesisë për rikonfigurimin e pagave të deputetëve, për të cilin tha se ka qenë kundër këtij vendimi.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare, më 29 dhjetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që seanca e ardhshme plenare të mbahet më 29 dhjetor 2009, me këtë

R e n d d i t e:

- 2.1 Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
- 2.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010,
- 2.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar,
- 2.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
- 2.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
- 2.6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,
- 2.7 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për borxhet publike,
- 2.8 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër korrupsionit dhe
- 2.9 Kërkesa e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kryesia vendosi që shqyrtimin e parë të Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës dhe të Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve ta shtyjë për seancën së parë të sesionit pranveror 2010.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Shqyrtimi i çështjes së ndërtimit të Qendrës Administrative Protolollare në Gërmi

Kryesia vendosi që çështjen e ndërtimit të Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi ta shtyjë për një mbledhje të veçantë, pas vitit të ri.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të SLS- së për lejimin e udhëtimit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori

V E N D I M

Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović dhe të anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, Slobodan Petrović, në Shqipëri, prej 22 deri më 24 dhjetor 2009.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**